

# Holokausti

përpiluar nga redaktorët

Bazat ideologjike | Policia kriminale dhe „regjistrimi etno-gjenetik i ciganëve“ | Dëbimet e para dhe internimet në kampet grumbulluese | Kampet punuese | Ekzekutimet masive | Getoja Lodz | „AuschWitz Erlass“ (dekreti i Auschwitz) | Viktimat | Të mbijetuarit

➤ *Persekutimi i “Ciganëve” që kishte zgjatur me shekuj arriti kulmin në gjenocidin e regjimit NS. Të definuar si “problem”, “asocial” dhe “inferior nga pikëpamja racore”, romët u arrestuan dhe vranë në Rajhin Gjerman dhe në territoret e pushtuara gjermane.*

## TRAURIGI ÇERHENI

*Traurigi çerheni ando učo nebo.  
Nan man blajbens ande mro šatno khere.  
Ari man line andar mro šatno vodro,  
mra džuvla muklom odoj le čavorenca.  
Traurigi çerheni ando učo nebo.  
Legede man andar mro šatno khere.  
Ando logeri man legede,  
odoj tharde man upro praho.*

## YLL I TRISHTUESHËM

*Yll i trishtueshëm në qiejt e lartë  
Nuk ka të ndenjur në shtëpinë time  
Ata më nxorën nga shtrati im  
Duke lënë gruan dhe fëmijët e mi.  
Ylli i trishtueshëm në qiejt e lartë  
Ata më morën nga shtëpia ime  
Ata më dërguan në kamp  
Ku më dogjën e bën pluhur.*

III. 1 Burgenland-këngë rome në kampet e përqendrimit, e kënduar nga Paula Nardai (nga Hemetek, Ursula / Heinschink, Mozes (1992):

Lieder im Leid. Zu KZ-Liedern der Roma in Österreich. In: Jahrbuch des Dokumentationsarchiv des österreichischen Widerstands: 76-93, Wien, p. 81)

## BAZAT IDEOLOGJIKE

Terminologjia qendrore dhe qëndrimet, të cilat më vonë u përdorën si arsye për vrasjen e “jetës së padenjës” nga Nazistët, ishte përcaktuar shumë më përpara se arritja e tyre në pushtet. Për shembull, shprehja “racë” është përdorur që nga shekulli i 17-të me qëllim të kategorizimit të popujve. Zakonisht, kjo bëhej sipas kritereve gjeografike të kombinuara me karakteristikat e jashtme, si ngjyra e lëkurës ose veçantitë tjera. Në shekullin e 18-të, Karl von Linné, themeluesi i sistematologjisë moderne i të gjitha gjërave të gjalla, dallonte njerëzit sipas ngjyrës së lëkurës (bardhë, kuqe, verdhë, zezë) në katër lloje dhe i atribuonte disa karakteristika secilit lloj.

Sipas tij, evropianët janë të bardhë, “të udhëhequr nga ligjet, optimist, dhe muskolor”, ndërsa aziatikët janë të verdhë të çelët, “të udhëhequr nga mendimet, melankolik dhe të ngurtë”. Shprehja “racë” deri më sot e në mënyrë të pazgjidhshme e gërshetuara me gjykimet mbi vlerën. Ngjyra e lëkurës si një mjet dallimi ende është e rëndomtë, edhe pse nocioni themelor i “racave” ka humbur kuptimin.

Në shekullin e 19-të qarkullojnë disa teori racore. Natyra e ndryshme e – 3 deri 11 racave, varësisht nga teoria individuale – u kthye në vlera të ndryshme. Vlera më e lartë iu atribuohet racës “Kaukaze”, “bardhë”, “Gjermane” ose “Ariane”. Në gjysmën e shekullit të 19-të, Arthur de Gobineau gjithashtu pohonte ekzistencën e “racave” të larta dhe të ulta në punimin e tij “Essai sur l’inégalité

des races humaines” (Ese mbi pabarazinë e racave njerëzore). Sipas mendimit të tij, “Arianët”, dhe “popujt Nordik” në veçanti i përkisnin racave të larta; prandaj, ai pasqyronte organin e përgjithshëm të mendimit. Mirëpo, ajo çka ishte e re, ishte refuzimi i tij i prerë i “përzjerjes” së “racave”, që do të rezultonte në degjenerim dhe përfundimisht në shkatërrim. Lidhur me këtë, pas disa vjetësh (1868) belgu Richard Liebich sajoi shprehjen “jeta e padenjës”.

Kundër historisë së biologjisë shkencore, që konsideronte faktorët trashëgues si themelor për ekzistencën njerëzore, idetë e racave superiore dhe inferiore, “të pastra” dhe “të përziera”, “të denja” dhe “jeta e padenjës” gjetën vendin e tyre në kriminologji. Në vitin 1876, italianii Cesare Lombroso, për herë të parë shpalli “tenden-

## Die Freigabe der Vernichtung lebensunwerten Lebens.

Ihr Maß und ihre Form.

Von den Professoren

Dr. jur. et phil. Karl Binding und Dr. med. Alfred Hoche  
früher in Leipzig in Freiburg

Verlag von Felix Meiner in Leipzig  
1920

III. 3

Paul Ansin, i quajtur Weiskopp, u largua nga "Wehrmacht" për shkak se ishte "Cigan". Ai u pushkatua në Auschwitz-Birkenau një ditë pasi arritjes së tij, ende në uniformën e tij.

(nga Gilsenbach, Reimar (1993): Oh Django, sing deinen Zorn. Sinti und Roma unter den Deutschen. Berlin: BasisDruck Verlag, p. 70)

III. 2

Libri "Die Freigabe der Vernichtung lebensunwerten Lebens" (Hapja e rrugës për asgjësimin e jetës së padenjë) nga juristi Karl Binding dhe doktor Alfred Hoche. Binding dhe Hoche, si të tjerët, u morën me kujdesin shtetëror të të sfiduarve mendor në aspektin e llogaritjes financiare të shpenzimit dhe fitimit. Rrjedhimisht, ata argumentuan se të gjithë ata, që ishin barrë për shoqërinë, duhet të vriteshin (ata që jetonin një "ekzistencë të padenjë").

"Mund të nxirret në përfundim se shpenzimet mesatare për person dhe vit për kujdesin e këtyre idiotëve janë 1,500 M. Nëse i mbledhim të gjithë idiotët në Gjermani që janë në spitale, do të fitojmë një total prej 20-30,000. Nëse supozojmë, për një rast individual, se personi do të jetojë për 50 vite, lehtë mund të shihet se një shumë e pamasë, në formën e ushqimit, veshmbathjes dhe ngrohjes, tërhiqet nga thesari nacional për shkaqe joproductive."

(përkthyer nga Binding, Karl / Hoche, Alfred (1920): Die Freigabe der Vernichtung lebensunwerten Lebens. Ihr Maß und ihre Form. Leipzig: Felix Meiner, p. 54)

cën gjenetike" përgjegjëse për veprat e supozuara kriminale të "Ciganëve" në punimin e tij "L'uomo delinquente" (Njeriu kriminal).

Ideja që racat mund të bëhen "superiore" përmes kontrollimit të lindjes, një ide që në masë të madhe besohej në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, u bashkua me thirrjen për "zhdukjen" e "popujve të pa trashëgueshëm (erbuntüchtige)" në Gjermani pas Luftës së Parë Botërore. Kërkesat higjienike racore radhiteshin prej internimit, tek abortimi dhe sterilizimi, e deri te eutanazia. Në vitin 1920, Karl Binding dhe Alfred Hoche kërkuan që të gjithë ata që jetonin një "ekzistencë të dërmuar" dhe që ishin "barrë për shoqërinë" të vriteshin. Në vitin 1923, katedra e parë e Higjienës Racore u mbajt në Minhen; mbajtësi i saj, Fritz Lenz, shkroi një tekst për "Menschliche Auslese und Rassenhygiene" (Përzgjedhjen njerëzore dhe higjienën racore), që më vonë pati një ndikim në "Mein Kampf" të Hitlerit. Organiza-

tat, grupet e shkencëtarëve, dhe individët privat me ndikim luftuan për shpërndarjen e ideve të higjienës racore, që ranë në tokën e pëlleshme të Gjermanisë së viteve të luftës. Partitë politike, posaçërisht Nazistët, përdornin këto ide për të fryrë flakën e zemërimit të ngritur ndaj çifutëve dhe grupet tjera të popujve. [III. 2]

Me 14 korrik, 1933, teoria racore më në fund u miratua nga ligjet e Rajhit të Tretë. Nocioni "jeta e padenjë" kishte një ndikim domethënës në politikën racore naziste. Në njërin anë, lindja "trashëgimtare (erbgesund)" dhe "Ariane" përkrahej, dhe në anën tjetër njerëzit e sfiduar nga aspekti mendor dhe fizik si dhe "asocialët" dhe "racat e huaja" persekutoheshin. "Ciganët", vendi i të cilëve nuk ishte lehtë të përcaktohej në sistemin për shkak të prejardhjes së tyre Ariane, në përgjithësi konsideroheshin "asocial" dhe rrjedhimisht shiheshin si një "racë asociale", në mungesë të një kriteri më të mirë.

### POLICIA KRIMINALE DHE "REGJISTRIMI ETNO-GJENETIK I CIGANËVE"

Sa i përket romëve, Nazistët nuk mund të përdornin vetëm paragjykimet negative që ishin rrënjësor thellë në popullsi, por edhe dekadat e përvojës policore lidhur me "murtajën Cigane". Edhe në Gjermani edhe në Austri centralizimi i policisë tradicionale "beteja Cigane" filloi në vitet e 1920-ta. Në fillim, regjistrimi i romëve nga autoritetet kishte për qëllim "luftimin parandalues të krimeve". Në vitin 1936, "Zentralstelle zur Bekämpfung des Zigeunerunwesens" (Byroja qendrore për luftimin e murtajës "Cigane") u themelua në Vjenë. Në Gjermani, propozimi i "Reichsführer SS" – Heinrich Himmler – për udhëheqës të forcës policore brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme hapi rrugën për veprim të "standardizuar".

Në fillim "Ciganët" ishin kundër prapaskenës shumë të përhapur anti -



Ekstrakt nga njoftimi i Reichsführer SS dhe Kreut të policisë gjermane në Ministrinë e punëve të brendshme, Heinrich Himmler, të datës 8 dhjetor, 1938, rreth luftimit të “murtajës cigane”.

“[...] 1 (1) Përvojat nga lufta ndaj murtajës cigane deri më tani dhe penetrimet e kërkimit racor-biologjik e bëjnë të duket logjike zgjidhja e pro-



blemit cigan përmes natyrës të racës së tyre. Përvoja ka treguar se gjysmë-të shumëzuarit përbëjnë pjesën më të madhe të kriminalitetit cigan. Përveç kësaj, përpjekjet për shtyrjen e Ciganëve që të vendoseshin dështuan veçanërisht me ciganët e pastër për shkak të instinktit të tyre të fortë migrues. Prandaj është e nevojshme të trajtohen Ciganët e pastër dhe ata gjysmë-të shumëzuar ndaras kur

është në pyetje çështja cigane. (2) Për të arritur këtë qëllim, së pari është e nevojshme të konstatohet përkatësia racore e çdo Cigani të vetëm që jeton dhe udhëton përreth, në mënyrën cigane, në Rajhun Gjerman.”

III. 4

(përkthyer nga: Ministerialblatt des Reichs- und Preussischen Ministers des Innern, Jg. 99, Nr. 51, 14.12.1938, f. 2105-2110)

“Cigane”, që kryesisht shihej si problem policor, por për shkak të ndikimit vazhdimisht të rritur të teorisë racore, aspekti racor në vlerësimin ideologjik të “Ciganëve” u bë gjithnjë e më i rëndësishëm. “Nürnberger Rassegesetze” (ligjet racore) të vitit 1935 kryesonin duke klasifikuar “Ciganët” si “inferior nga pikëpamja racore” dhe duke iu marrë të drejtat e tyre nacionale dhe qytetare. Ishte roli i shkencëtarëve për të dëshmuar më vonë që këto dogma ishin të drejta. Prandaj regjimi nazist gjeti një “armik” tjetër, shpifja dhe zhdukja e afruar e të cilit do të bashkonte “popullin gjerman”.

Kur Robert Ritter, doktor dhe psikiatër, mori pozitën udhëheqëse në “Rassenhygienische und erbbiologische Forschungsstelle” (Qendra Kërkimore për Higjienë Racore) e Departamentit të Shëndetit Publik të Rajhit, ai u bë një figurë qendrore në “kërkimin Cigan” në Rajh. Qëllimi i tij i vërtetë ishte të dëshmonte si sjellja kriminale dhe “asociale” ishte trashëguese. Deri-

sa Çifutët ishin akuzuar për “shpërbërje” intelektuale të strukturës së shtetit, “Ciganët” ishin shpallur “primitiv”, “të varfër në kulturë” dhe pa histori, të cilët kërcënonin rendin moral duke “përzier” dhe “ndërtuar një nën-proletariat kriminal” për shkak të racës së tyre. Tanimë deri në vitin 1935, kërkesa u bë që “Ciganët” duhet të internoheshin në kampe të punës dhe të sterilizoheshin me dhunë. Përqendrimi kryesor i Ritterit ishin “gjysmë-shumëzimet Cigane”, ku klasifikimi ishte madje më i gjerë se me Çifutët: njerëzit shpallëshin “gjysmë-shumëzim Cigan” nëse njëri nga tetë stërgjyshërit ishte “Cigan”. [III. 9]


Në fund të vitit 1938, Heinrich Himmler e bëri publike se ai do të “zgjidhte çështjen Cigane përmes natyrës së asaj race”. Mirëpo, teoritë e shkencëtarëve dhe politikanëve nazist mbetën kundërtënëse deri në vitet 1942/43. Në njërën anë, origjina indiane e romëve i klasifikonte ata si “Arian”, por në anën tjetër politikanët

dhe shkencëtarët donin të dëshmonin “racën e tyre të huaj” (Artfremdheit) në mënyrë që të përlligjin persekutimin e tyre. [III. 4, 5]

Për shkak të kundërtënieve ideologjike, persekutimi i “Ciganëve” u krye në një mënyrë shumë më pak të koordinuar sesa ai i popullatës Çifute. Për shembull, disa romë ende ishin në ushtri në vitin 1943, edhe pse vetë ajo ushtri ishte e përfshirë në gjenocidin romë në lindje, dhe edhe pse me mijëra tanimë ishin vlarë në kampet e përqendrimit. Këta anëtarë të ushtrisë u dëbuan drejtpërdrejtë nga fronti për në Auschwitz, nganjëherë madje edhe me medalje nderi. [III. 3]

#### DËBIMET E PARA DHE INTERNIMET NË KAMPET GRUMBULLUESE

Pasi që romët u zhveshën nga të gjitha të drejtat dhe mundësitë e të ardhurave, ata shpesh duhej të mbështetes-



III. 5

Në letrën naziste “Rechtsspiegel” të datës 24 shkurt, 1939:

“Në dekretin e tij të 8 dhjetorit, 1938, Reichsführer SS dhe krye i policisë gjermane skicuan udhëzimet e përgjithshme për luftimin e ciganëve në tërë Rajhun. Dekreti është i bazuar në përvorjat dhe perceptimet e fituara nga luftimi i murtajës cigane deri më tani. Ai dëshiron, dhe duke bërë këtë e zhdruk të ligën, për të zgjidhur çështjen cigane përmes natyrës së asaj race.”

(nga Hancock 2002, f. 40)

hin në bamirësinë e autoriteteve lokale, për të cilët ata ishin një tendosje e konsiderueshme. Kjo tendosje, e shkaktuar nga nazistët, përdorej si pretekst për fillimin e masave të persekutimit kundër romëve. Shqetësimi kryesor i higjienistit racor ishin të ashtuquajturit “gjysmë-shumëzimet Cigane”. Gjatë fushatës së “Arbeitscheu Reich” (Rajhi Dembel), i cili ishte drejtuar kundër lypësve, prostitutave, endacakëve dhe “Ciganëve” filluan arrestimet e para. Me urdhrat e Reichskriminalpolizei (Zyrës së Policisë Kriminale të Rajhit), 700 romë gjerman, shumica e tyre Sinti, u dëbuan në kampet e përqendrimit Dachau, Buchenwald, Sachsenhausen dhe Lichtenburg në qershor 1938.

Pas një viti, 3,000 romë gjerman dhe austriak u dëbuan në kampet e përqendrimit Dachau, Mauthausen, Ravensbrück dhe Buchenwald. Autoritetet naziste dhe policia mund të mbës-

hteteshin në hetimet policore të viteve të luftës për sa i përkiste regjistrimit të romëve.

Përshkak të “Festsetzungserlass” (urdhëresës për ndalimin e lëvizjes) nga Himmler dhe Heydrich (1939), romët nuk lejoheshin të braktisnin qytetet ku jetonin. Nëse ata nuk respektonin këtë dekret, ata menjëherë dërgoheshin në kampet e përqendrimit. Sipas urdhrave të Himmlerit (“Schnellbrief”), ndodhi një valë e internimeve në kampet e përqendrimit në vitin 1939. Qëllimi i vërtetë i atij dekreti ishte përqendrimi i të gjithë “Ciganëve” në Rajhun Gjerman – ku numri i tyre ishte përafërsisht 30,000 – në kampet dhe dëbimi i tyre sa më shpejtë në “Generalgouvernement” në Poloni. Dekreti nuk arriti shpejt të kthehet në veprim, dhe për këtë “kampet e përkohshme grumbulluese” u shndërruan në “kampe punuese” të ngjashme me kampet e përqendrimit. [III. 6]

## “GESTORBEN”

Rreth gjysma e të burgosurve të “kampit Cigan” Çek, Lety/Lettig ishin fëmijë deri në moshën 14 vjeçare. Në librin e tij “Holokausti i romëve Çek”, historiani Ctibor Nečas shënon fatin e tyre në hollësi. Një pasazh lexon:

“Më dëshpëruese dhe të vetmuara duhet të kenë qenë ditët e fundit të fëmijëve bonjak dhe të braktisur, prindërit e të cilëve kishin vdekur ose ishin transferuar në spital, dhe të cilët kishin mbetur vetëm. Kur ata u gjetën të vdekur, abdikimi i tyre u regjistrua në dosjen e tyre personale me shumë vonesë dhe shënimet janë të paplota ose madje të gabuara.

Për shembull, datat e vdekjes së Františka Čandová, Jan Marion Čermák-Růžička, Marie Petržilková, Jiří Růžička, Václav František Růžička, Zdeněk Růžička, Božena Františka Růžičková, Josefa Růžičková dhe Marie Růžičková jepen vetëm sipas muajit, ndërsa ajo e František Florián vetëm sipas vitit. Dosjet e Ondřej Růžička dhe Růžena Růžičková thjesht janë të shënuara si ‘gestorben’ [të vdekur] dhe asnjë datë nuk jepet. Edhe dosjet e Jan Růžička dhe František Procházka janë të një karakteri të ngjashëm të pakët të cilat përmbajnë vetëm një shënim ‘data e vdekjes e panjohur.’ Disa nga fëmijët e vdekur madje nuk ishin identifikuar në mënyrë të duhur.”

III. 6 (nga Nečas 1999, f. 91f.)

## KAMPET PUNUESE

Një numër i kampeve punuese u ndërtuan në Gjermani, Austri në post-Anschluss dhe në territoret e okupuara gjermane të Evropës qendrore dhe lindore. Fillimisht, shumica e këtyre kampeve u projektuan si kampe punuese ndëshkuese vetëm për meshkujt punues romë, sikurse shumë kampet në Austri dhe Gjermani. Për shembull, në Austri kishte 17 kampe të madhësive të ndryshme.

Disa nga këto “kampe punuese”, sikurse kampi Lety në Boheminë jugore, ose ajo në kompleksin Belzec në Poloni, u shndërruan në “kampe Cigane” për meshkujt, femrat dhe fëmijët romë. Shumë kampe u mbyllën në vitin 1943; të burgosurit ose u dëbuan në kampet e vdekjes, në kampet tjera punuese ose vriteshin në vend. Disa kampe ekzistuan deri në vitin 1944, si për shembull Dubnica dhe Vahom në Sllovakinë përëndi-

### KATEGORIZIMI HIGJIENIK RACOR

*Deri në vitin 1944, kur klasifikimi i romëve më në fund mbaroi, Rassenhygienische und bevölkerungs-biologische Forschungsstelle (Byroja e Kërkimit për Higjiënë Racore) nën Ritterin kishte "kategorizuar" rreth 24,000 njerëz; shumica e të cilëve nuk ishin më të gjallë në atë kohë.*

(shiko Lewy 2001, f. 105)

*"Ritteri e bëri me gjakftohtësi, në rrugë, në mënyrë miqësore. Njëri pas tjetrit ishin sjellë përpara dhe ishin ulur në një karrige. Pastaj ai krahasonte sytë e fëmijëve, na shtroi të gjithëve shumë pyetje, dhe Justini i shënoi të gjitha. Pastaj ai tha, "Hape gojën", dhe ai kishte një lloj instrumenti me të cilin maste fytyrën, vrmat e hundës, rrëzën e hundës, pjerrësinë e syve, ngjyrën e syve, vetullat, veshët nga brenda dhe jashtë, qafën, duart, çdo gjë që mund të matej."*

III. 7

(përkthyer nga Krausnick, Michael (1995): Wo sind sie hingekommen? Der unterschlagene Völkermord an den Sinti und Roma. Gerlingen: Bleicher Verlag, p. 97)

### VRASJET E ROMËVE NË ZONËN E VARSHAVËS

*Hulumtuesi romë polak Jerzy Ficowski shkroi atë që deri më sot është përshkrimi më i plotë i persekutimit të romëve polak nga trupat gjermane. Ai flet për periferitë dhe zonën e Varshavës:*

*"Shpesh, rezultati ishte aq i përgjithshëm, sa që vetëm vrasësit mbeteshin si dëshmitarë. [...] In 1942, Fashistët e Hitlerit vranë shumë ciganë në periferitë e Varshavës; përfshirë 30 njerëz në Grochów, meshkuj, femra, dhe fëmijë dhe gjithashtu disa familje në Targówek. Shumë u pushkatuan në vitin 1943 në Bem-Fort, në Komorowa afër Varshavës u vranë femra dhe fëmijë, në pyje afër Zyrardów një familje cigane u pushkatua, në pyjet e Brack dhe Gazyck afër Sochaczew më shumë se dymbëdhjetë familje u vranë; ngjashëm ciganët në Konsk, Sochaczew, Marki; në Sielce në Varshavë shtatë familje u dogjën të gjallë në një hangar të drurit; në Jadów Ciganët e zonës u rrethuan dhe u mbyllën në sinagogën lokale, dhe të gjithë meshkujt u pushkatuan. Femrat arritën të iknin gjatë natës në Karczewo, ku pas një kohe të shkurtë policia gjermane filloi t'i vriste Ciganët, në mes të tjerave duke gjuajtur fëmijët jashtë dritareve në rrugë. Shumë nga Ciganët kishin revole, dhe luftuan kundër Xhandarmërisë deri në plumbin e fundit. Vetëm në rastet e veçanta, njerëzit arritën të iknin. Në një fshat afër Milosna më shumë se 20 njerëz, në mesin e tyre më shumë se dymbëdhjetë fëmijë, u pushkatuan në janar të vitit 1943. Në tetor të vitit 1944 njerëzit e Gestapos pushkatuan 104 Ciganë afër Puszca Kampinowska; vetëm një njeri i vetëm arriti të ikte. Vrasjet e atij lloji ndodhnin shumë më shpesh. [...]"*

III. 8

(përkthyer nga Ficowski 1992, f. 65f.)

more. Kampi më i madh i "Ciganëve", Lackenbach në Burgenland, që kishte deri në 2,300 të burgosur në vitin 1941, vazhdoi të ekzistonte ekzistoj deri në fund të luftës.

Të burgosurit duhej të kryenin punë të vështira fizike: ata duhej të gërmnin degë lumi, ujdise të lumit, ose rezervuare, të bënin punime në rrugë, punë në fusha, dhe të punonin në kompanitë e të gjitha llojeve. Vdekshmëria ishte e lartë, për shkak të ushqimit të dobët, punës së vështirë, dhe sëmundjeve. Në Lackenbach, 237 njerëz vdiqën gjatë pesë viteve të ekzistencës së kampit; në Lety, së paku 326 njerëz gjatë tri viteve; në Belzec, edhe pse nuk ka numra të saktë, vdekjet besohet të kenë qenë ngjashëm të larta.

### EKZEKUTIMET MASIVE

Vrasja sistematike e romëve filloi në verë të vitit 1941, të shkaktuara

nga sulmet gjermane ndaj BRSS-së. Si "bashkëpunëtorë" dhe "spionë" të "Bolshevizmit Çifutë" me mijëra romë ranë viktima të ekzekutimeve masive nga SS "Einsatzgruppen" (task forcat) të cilët, me ndihmën e ushtrisë, i vranë ata pas frontit. Ndryshe nga veprimet e ndërmarra në Gjermani, shqetësimi kryesor i policisë në shumicën e fushave ishte udhëtimi, Ciganët "e pastër nga raca" dhe "Ciganët e martuar brenda fisit" të cilët, si një popullatë lëvizëse, më së miri i përshtateshin imazhit të spiunëve. 33,000 Çifutë, dhe qindra romë ishin në mesin e viktimave të vrasjeve masive në Babi Jar afër Kievit, që u kryen nga "Einsatzgruppe C" së bashku me "6. Armee". Sikurse në Bashkimin Sovjetik, më shumë romë u vranë përmes ekzekutimeve masive sesa në kampet e Polonisë dhe terri-toreve tjera të Evropës lindore dhe Ballkanit të okupuara nga nazistët. Nuk ka në dispozicion numra të saktë,

por vlerësimet e kujdeshme flasin për shumë më tepër se 100,000 njerëz që u vranë jashtë sistemit të kampeve. [III. 8]

Në Serbi, të okupuar nga gjermanët që nga viti 1941, të ashtuquajturat "ekzekutime hakmarrëse", në të cilat Çifutët, Serbët dhe Romët ranë viktima, ishin të rëndësishëm së njëjtë në shuarjen e minoritetit romë. Ndryshe nga lindja, "Einsatztruppen" zgjidhte viktimat, dhe ushtria kryente ekzekutimet. Harald Turner, kreu i administratës ushtarake gjermane, deklaroi në vitin 1942 se Serbia ishte i vetmi vend në të cilin "çështja Çifute dhe Cigane" ishte "zgjidhur". "Einsatzgruppen" dhe forcat e armatosura u përkrahën nga organizatat lokale fashiste. Në Kroaci ushtria "Ustashe", dhe në Hungari, sipas rregullit gjerman prej vitit 1944 e më tej, fashistët "Kryqi me shigjetë" kryen ekzekutimet masive, organizuan dëbimet dhe udhëhiqnin kampet.

Geto Lodz

„Auschwitz Erlass“ (dekreti i Auschwitz)

Viktimat

Të mbijetuarit

## PUNA E DR. MENGELE

*Përzgjedhjet e Mengeles në platformën hekurudhore në Birkenau, ku ai bënte eksperimente me derrat e Gvinesë, janë mirë të njohura. Ai bëri eksperimentet e tij në Barakën No. 32 të sektorit të Familjeve Cigane, duke sakatuar dhe vrarë me qindra njerëz në emër të shkencës. Helmut Clemens, tetëmbëdhjetë vjeç në atë kohë, duhej të punonte në repartin e të sëmurëve si korrier për Mengelen. Atje ai ishte dëshmitar okular i krimeve të Mengeles:*

*“Në mbrëmje unë duhej të tërhiqja trupat që ishin grumbulluar në një kasolle të vogël, të shënoja numrat nga krahët e tyre dhe t’i dërgoja disa prej tyre tek Dr. Mengele. Ai pastaj i priste ata në mënyra të ndryshme. Në raftet kishte vorba në të cilat kishte organe – zemra, trurë, sy, dhe pjesë të tjera të trupit.”*

III. 9 (Fines 1997, f. 104)

29. JUN. 1944  
Hyg.-bakt. Unters.-Stelle  
der Waffen-SS, Südost  
Auschwitz OS. am 29. Juni 1944.  
Anliegend wird übersandt:  
(12-jähriges Kind)  
Material: Kopf einer Leiche entnommen am  
zu untersuchen auf: Histologische Schnitte  
Name, Vorname:  
Dienstgrad, Einheit: siehe Anlage  
Klinische Diagnose:  
Anschrift der einsendenden Dienststelle: K.-Krankenbau  
Zigeunerlager Auschwitz II, B II e  
Bemerkungen: Der 1. Lagerarzt  
K.I. Auschwitz II  
Mengele  
SS-Hauptsturmführer.  
(Stempel, Unterschrift)

III. 10

*Dokumentet mjekësore që kërkonin ekzaminimin histologjik të kokës së një fëmije rom, të datës 29 qershor, 1944, dhe nënshkruar nga Joseph Mengele.*

(nga Hancock 2002, f. 49)

## GETO LODZ

Sikurse u përmend më lart, romët fillimisht duhet të kenë qenë internuar në “Generalgouvernement Polen” në “kampet grumbulluese” vetëm për të pritur “dëbimin e tyre të fundit” (“Schnellbrief” i Himmlerit i vitit 1938). Në geton çifute të Lodz (“Litzmannstadt”) një “kamp Cigan” u ndërtua në vitin 1941 sipas urdhrave të Himmlerit. SS-ët, “Jüdische Ordnungsdienst” (forca e sigurisë Çifute) dhe “policia Cigane” të krijuar posaçërisht për atë detyrë kishin për detyrë të bllokonin lagjen nga pjesa tjetër e getos dhe botës së jashtme. Asnjë informatë për kushtet e kampeve nuk dërgohej jashtë. Në mes të 5 dhe 9 nëntorit, 1941, 5 transportime me gjithsej 5,007 romë nga Austria arritën në geton Lodz. Anëtarët e SS-it dhe “Reichsarbeitsdienstes” (forca punëtore e Rajhut) siguruan kampin dhe detyruan disa të burgosur që të kryenin punë të dhunshme. Romët duhej të flinin në dysheme dhe nuk merrnin as medikamente as ushqim të mjaftueshëm. Pas një kohe të shkurtër u paraqitën ethet e tifos. Ata 4,400 njerëz të cilët ende ishin të gjallë në janar të vitit 1942 u sollën me ka-

mion në kampin e asgjësimit Chelmno/Kulmhof dhe u vranë në vagonë të gazit. Asnjë nga 5,007 romët austriak nuk mbijetoi.

## „AUSCHWITZ ERLASS“ (DEKRETI I AUSCHWITZ)

Me 16 dhjetor, 1942, Heinrich Himmler dha urdhëresën që të gjithë “Ciganët” që ende jetonin në “Rajhun Gjerman” të dëboheshin në Auschwitz. “Dekreti i Auschwitz” ishte zbulimi final i një plani që në fakt kishte ekzistuar që nga viti 1938 dhe që pjesërisht veçse ishte realizuar, e që ishte asgjësimi i plotë i “Ciganëve”. Urdhri i Himmlerit për dëbim u drejtua kundër të gjithë “gjysmë-të shumëzuarve Ciganë, Ciganëve-Rom dhe Ciganëve të Ballkanit”, ku “shkalla e gjysmë-shumëzimit” nuk ishte më e ndonjë rëndësie. Përrjashtimi i një grupi të vogël të “Ciganëve të pastër nga pikëpamja racore”, të cilët duhej të përdroreshin si “ekspozita në muze” në muzeun e hapur të Himmlerit, ekzistoi vetëm në letër.

Në të ashtuquajturin “kamp familjar të Ciganëve” Auschwitz, më shumë se 20,000 romë, të cilët në masë

të madhe kishin ardhur nga “kampet grumbulluese” në Gjermani, Austri, Poloni, Bohemi dhe Moravi, u vendosën bashkë në vendet më të vogla. 32 baraka të drurit, secila prej të cilave fillimisht është dashur të përdoret për 52 kuaj, u përdorën si akomodim. Deri 600 romë u vendosën në një barakë të tillë. Gjithashtu rrethanat sanitare ishin të tmerrshme. Tanimë pas disa muajve me qindra romë kishin vdekur nga mosushqimi, epidemitë dhe puna e dhunshme.

Romët u shfrytëzuan për punën më të vështirë me baltë dhe ndërtime brenda kampit. Epidemia e urisë “Noma” u xhindos në mesin e fëmijëve. Përveç kësaj, sistemi i kampeve u shënjua nga strukturat e brendshme të pushtetit. Të burgosurit politik ishin në fundin e lartë, ndërsa çifutët dhe romët në fundin e poshtëm të hierarkisë. Stereotipat dhe paragjykimet u ndërmorën nga komuniteti i kampeve. Identifikimet e atribuara nga SS e bënë të mundshme njohjen e shpejtë. Romët mbanin një trekëndësh ngjyrë kafe ose të zezë, numri i të burgosurit të paraprirë me “Z” (për “Zigeuner”) u bë tatuazh në parakrah.

Nga të gjitha kampet e Auschwitz, “kampi i Ciganëve” kishte sh-

III. 11

*“Qaj / vëllai im Ossi Z 5743 në Birkenau  
1943 vdiq nga uria dhe ethet e tifos”.*

*Piktura nga Karl Stojka.*

(nga Stojka, Karl (1990): Ein Kind in Birkenau.

Wien: e vetë-publikuar, faqja e parme)

*Piktori austriak, Karl Stojka, ishte një  
djalë 12 vjeçar kur u dëbua në Ausch-  
witz-Birkenau me familjen e tij në vitin  
1943. Ai kujton vdekjen e vëllait të tij  
të vogël:*

*“Vëllai im Ossi vdiq nga uria. Ai ishte  
në shtratin e lartë, shtatë vjeçar, dhe  
ne duhej të shkonim të punonim dhe ai  
mbetej vetëm! Dhe kur të tjerët i jipnin  
më shumë bukë, atëherë më të vjetrit ia  
vidhnin bukën dhe çajin dhe supën. Dhe  
kështu ai vdiq urie. Ku ishte Zoti?”*

III. 12

(nga Cech / Fennesz-Juhász / Heinschink 1999, f. 117)



kallën më të lartë të vdekshmërisë. 19,300 njerëz humbën jetën e tyre aty; 5,600 u helmuan me gaz, 13,700 vdiqën nga uria, sëmundjet, epidemitë dhe eksperimentet mjekësore. Këto të fundit përdoreshin për të dëshmuar ndikimin fatal të “racës” dhe trashëgimisë. Imagjinata e doktorëve që ishin përgjegjës për këtë detyrë, më i shquari Josef Mengele, nuk kishin kufij. Romët u injektuan me tretësira të kripura dhe bacile tifoje, doktorët provuan pigmentet me ngjyrë dhe injeksionet e zemrës për të ekzaminuar sytë e binjakëve. Kështu, doktorët, anëtarë të SS dhe të ushtrisë vepruan nga ndjenja e shkencës të shpërndarë në popullsinë e përgjithshme. [Ils. 9-12]

Auschwitz është vetëm njëri nga shumë kampe përqendrimi në të cilin romët u vranë, pjesërisht përpara dhe sistematikisht pas “Dekretit të Auschwitz”. Përveç kësaj, u realizua elementi i dytë i politikës së asgjësimit, e që ishte sterilizimi i dhunshëm, edhe brenda kampeve dhe jashtë në spitale. Me mijëra romë, shumica gra dhe vajza, duhej a vuanin këtë operacion, shpesh edhe pa anestezi. Shumë vdiqën gjatë operacionit.

## VIKTIMAT

Ende nuk dihet sa romë ranë viktimat të persekutimit nazist. Romët nuk regjistroheshin gjithmonë si të tillë, dhe paraqiteshin në statistikat e viktimave si anëtarë të popullsisë shumicë, si “të tjerë” ose fare hiq. Dokumentet nga kampet e asgjësimit dhe listat e dëbimeve ishin humbur, janë kërkuar në arkivat e shumta ose ende nuk janë analizuar. Shënimet e mbijetuara nga forcat e armatosura dhe SS (“Schutzstaffel”, skuadrilja mbrojtëse) të cilët me radhë kryenin vrasje pas frontit lindor, shpesh me zgjedhjen e tyre, janë të paplota dhe të gabueshme veçanërisht në aspektin e romëve. Vrasjet e viktimave të panumërueshme, në ekzekutimet masive si dhomat e gazit, nuk janë dokumentuar fare. Kërkimi duhet të mbështetet në vlerësime; çfarëdo të ishte dëshmia e tyre, një numër prej së paku 250,000 viktimave konsiderohet si shumë i besueshëm.

Diskutimi publik i asaj teme, nëse bëhet fare, shpesh bazohet më shumë në motivet personale sesa në fakte. Në njërin anë, organizatat rome, motivi i tyre duke qenë i qartë, prirjen të vlerësojnë numrin e viktimave si

shumë të lartë. Për shembull, aktivistët minoritar ishin të mendimit në publikun gjerman se gjenocidi kishte pasur 500,000 apo madje 750,000 viktimat – numra të cilët nuk janë konfirmuar nga kërkuesit. Në anën tjetër, historianët e motivuar nga pikëpamja racore vunë në dyshim gjithë kërkimin në këtë temë dhe, rrjedhimisht, edhe gjenocidin e vet romëve. Për më tepër, kërkimi historik serioz gjithashtu prirte të mohojë persekutimin e romëve me karakter racor. Arsyeja e kësaj shpesh është motivi për t’i dhënë drejtësi fatit të çifutëve në veçorinë e saj tragjike.

Një gjë është e qartë: Sikurse popullsia çifute, romët u zhveshën nga të drejtat e tyre, u internuan dhe u vranë në Rajhun gjerman. Vepri i dokumentuar i persekutimit dhe numri i krimeve të marra vetëm nga dokumentet mund të mos arrijnë në asnjë përfundim përveç atij se ishte vrasje masive me motive “racore”. Nëse, siç është theksuar shpesh, elementi i veçantë, historikisht i ri dhe i padëgjuar i asgjësimit të çifutëve ishte saktësia e makinës dhe dimensionit industrial, atëherë elementi i veçantë i vrasjeve të romëve ishte lehtësia me të cilën ishin pranuar në rrethin e vikti-

### “SHPIRTRAT E TYRE JANË TË SËMURË”

*Romë austriak Ceija Stojka nga grupi Lovara, i mbijetuar i kampit të Auschwitz dhe shkrimtar e piktor i njohur, përshkruan se si fëmijët e të mbijetuarve vuanin gjithashtu nga trauma e Holokaustit trauma:*

*“Kur dolëm jashtë, ne ishim të sëmurë, tërësisht! Zemra ishte plagosur, kokat tona, shpirtrat tanë ishin të sëmurë. Dhe në atë kohë në këtë botë shteti—jo romët ose të vdekshmit normal, por shteti, duhej të kishte mendjemprehtësinë të mundësonte, ashtu si mundësohet sot, ndriçimin e mendjes dhe bisedimin për atë se çka do të ishte e nevojshme. Këta njerëz duhej të*

*ishin trajtuar. Ata nuk duhet të kishin pasur fëmijë për pesë, gjashtë vjet, ata pak njerëz të cilët dilnin, të cilët ende ishin atje, derisa të kishin mjaft forcë për të qenë të shëndetshëm, për të pasur mundësi të qeshnin prapë, derisa të ndiheshin mjaft mirë për të parë se bota nuk është e keqe dhe derisa ata do guxonin të sillnin fëmijë të shëndoshë në këtë botë. Në atë kohë, natyra e bëri të veten: bota është e bukur, lulet po çelin. Dhe ka dashuri në botë, natyra e pa atë. Por fëmijët tanë – ajo është shumë normale, dhe besoj se çdo person i cili mendon vetëm pak do të thotë të njëjtën gjë, se ata fëmijë ishin shumë të ndjeshëm, çdo gjë brenda tyre, zemra e tyre dridhej, dhe vajtonte menjëherë. Sepse zemrat e tyre dhe shpirtrat e tyre janë të së-*

*murë. Dhe ne kemi futur këtë sëmundje brenda tyre. Kjo frikë, gjithmonë frika, fëmijët rriteshin me të. Dhe kjo është pse ata gjithmonë ata kthehen prapa kur ecin në rrugë, a kuptoni, ata kthehen prapa. Vetëm personi që është i frikësuar kthehet prapa!*

*Kur dikush sëmurët nga kampi, dhe koka i dhemb dhe shpirti i gjakon për babën, motrën, vëllain që qëndronte aty, ky person vetëm mund të ketë fëmijë që është i plagosur në shpirt. Fëmija vjen në këtë botë, mund ta shihni sa i ëmbël është, sa i bukur, ju e rritni, e doni dhe e puthni, e përqaftoni. Ai rritet, por kjo frikë që ishte brenda juve, ju e kaloni tek ai, me qumështin e nënës.”*

III. 13

(nga Cech / Fennesz-Juhász / Heinschink 1999, f. 77)

mave dhe rastësia me të cilën vrasjet u kryen, edhe pse deri në fund mund të mos kishte pasur një plan qartësisht të formuluar dhe gjithëpërfshirës për asgjësimin e tyre.

### TË MBIJETUARIT

Pas luftës, romët e mbijetuar u ballafaquan me paragjykimet e njëjta të

cilat duhej t'i sdurojnë tanimë para vitit 1933 në tërë Evropën. Pas vitit 1945, nuk kishte fare interes publik në fatin e tyre. Vetëm në fund të viteve të 1970-ta popullsia shumicë zhvilloi një ndjenë të padrejtësisë, ku iniciativa u ndërмор nga organizatat rome të cilat ishin në gjendje të krijojnë vetën që nga ajo kohë e tutje. Paragjykimet e vazhdueshme kishin ndikim në të ashtuquajturat “ripa-

rime”. Vetëm një pakicë e romëve të mbijetuar gjerman dhe austriak ishin në gjendje të mbronin kërkesat e tyre. Fajtorët austriak dhe gjerman kryesisht shpëtonin pa burgim ose fitonin amnistinë pas një kohe të shkurtër. Ata pak romë të cilët nuk iu nënshtruan presionit dhe ngritën akuza, në shumë raste prapë u diskredituan dhe u flakën si gënjeshtarë. [III. 13]

### Bibliografia

**Cech, Petra / Fennesz-Juhász, Christiane / Heinschink, Mozes F. (eds.) (1999)** *Lovarenge paramiči taj textura anda Österreich, kotor II. Wien: Romano Centro* | **Ficowski, Jerzy (1992)** *Wieviel Trauer und Wege. Zigeuner in Polen. Frankfurt/Main: Peter Lang* | **Fings, Karola (1997)** *Romanies and Sinti in the concentration camps. In: Fings, Karola / Heuss, Herbert / Sparing, Frank (eds.) From “Race Science” to the Camps. The Gypsies during the Second World War 1. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 72-109* | **Hancock, Ian (2002)** *We are the Romani people. Ame sam o Rromane džene. Hatfield: University of Hertfordshire Press* | **Kenrick, Donald / Puxon, Grattan (1995)** *Gypsies under the Swastika. Hatfield: University of Hertfordshire Press* | **Lewy, Guenter (2000)** *The Nazi Persecution of the Gypsies. Oxford: Oxford University Press* | **Nečas, Ctibor (1999)** *The Holocaust of Czech Roma. Prague: Prostor*



© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) ose mekanike, përfshirë fotokopjimi, incizimi apo sistemi i ruajtjes ose mbajtjes së informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Botimit, Drejtoria e Komunikimit (F-67075, Strasbourg cedex ose publishing@coe.int)



PROJEKT PËR EDUKIMIN E  
FËMIJËVE ROMË NË EVROPË  
<http://www.coe.int/education/roms>

[romani] PROJECT <http://romani.uni-graz.at/romani>